



**Analizë e raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të  
Hekurudhave të Kosovës për vitin 2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

---

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) për vitin 2017. Kjo analizë përkon me rëndësinë e vazhdueshëm që INDEP i cakton agjencive të pavarura dhe instrumenteve mbikëqyrëse së punës së tyre, kështu duke e cilësuar transparencën dhe llogaridhënien si faktorë kyç në funksionimin e tyre. ARH prezanton në raportin e tyre vjetor punën e bërë gjatë vitit në kornizën e fushëveprimit institucional dhe katër fushave të kompetencave ligjore të ARH: licencimit, sigurisë, interoperabilitetit dhe rregullimit të tregut.

## Përmbledhja Ekzekutive dhe Raportimi Institucional

Në seksionin e përmbledhjes ekzekutive, ARH në përgjithësi përmbush kërkesat minimale të raportimit. Në këtë seksion, autoriteti ka përfshirë të dhëna rreth pikave kryesore të cilat elaborohen në raport, si dhe arritjet e tij. Megjithatë, përmbledhja ekzekutive e raportit nuk përfshinë një analizë të detajuar të objektivave të ardhshme të ARH-së. Këto objektiva gjithashtu nuk shtjellohen në pjesë të tjera të raportit. Mungesa e objektivave të çfarëdo horizonti kohor do të thotë se monitorimi i vazhdueshëm dhe kualitativ i ARH-së nga Kuvendi i Kosovës është i vështirë. Si rezultat, ARH duhet të zhvillojë brenda raportit vjetor një seksion ku tregohen qartë objektivat specifike të autoritetit dhe arritjet rreth përmbushjes së këtyre objektivave vit më vit.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, ARH gjithashtu ka reflektuar në detaj punën e përgjithshme institucionale sa i përket paraqitjes dhe analizës rreth zhvillimit të bazës ligjore dhe rregullative. Sipas planit të punës, ARH ka paraparë përgatitjen dhe hartimin e akteve nën-ligjore për përmbushjen e detyrave të autoritetit dhe për përmbushje të pajtueshmërisë me Direktivat e BE-së. Gjatë vitit 2017, ARH ka paraqitur arritjet e saj nëpërmjet përpilimit të 6 rregulloreve të reja dhe plotësimit të 2 rregulloreve ekzistuese.

Në kapitullin 2.3 të raportit, ARH deklaroi se ka pasur vështirësi ligjore në përmbushjen e misionit të saj. ARH pretendon se problemet ligjore ndërliken me mos ndarjen adekuate të kompetencave në mes të ARH dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe mospërputhjes së rregulloreve të ARH dhe Direktivave të BE-së. Megjithatë, në këtë kapitull mungon elaborimi i natyrës së saktë të problemeve dhe hapave të cilat ARH po ndërmerr për të zgjidhur problemet e identifikuara. Si rezultat, INDEP thekson nevojën që ARH të paraqesë më shumë informata rreth problemeve dhe hapave që po ndërmerren për të zgjidhur këto probleme në raportim ndaj Kuvendit të Kosovës sa i përket kornizës ligjore të saj.

Pas analizës, INDEP beson se ARH ka bërë një përshkrim adekuat të misionit, vizionit dhe kompetencave të autoritetit. Gjithashtu, ARH ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të saktë organogramin e përgjithshëm të organizatës dhe analizën se si departamentet e ARH-së ndërliken me kompetencat dhe detyrat ligjore të këtij institucioni. Gjatë kësaj analize, INDEP ka vënë re disa fusha në të cilat kërkohet përmirësim në të ardhmen.

---

<sup>1</sup> Duhet theksuar se ARH në faqen 33 të raportit ka paraqitur planin e punës dhe realizimin e tij për 2017. Megjithatë, objektivat ndryshojnë nga plani i punës dhe për shkak të kësaj, INDEP vlerëson se duhet zhvilluar një seksion i ndarë për qëllim të objektivave.

Së pari, ARH duhet të sigurohet që në kapitullin 2.4 për Bordin Mbikëqyrës të përfshijë emrat e personave të cilët janë anëtarë të bordit dhe mandatet e tyre. Këto informata ndihmojnë në rritjen e transparencës dhe monitorimin më të mirë nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu, në seksionin e bordit, ARH duhet të shpjegojë nevojën dhe arsyen rreth sesioneve të jashtëzakonshme të Bordit Mbikëqyrës. Në raport nuk jepen të dhëna të detajuara rreth këtij sesiioni dhe nevojës për të, që ngrit pyetje rreth problemeve me të cilat ballafaqohet ARH.

Për më shumë, te seksioni i organizimit institucional dhe deklaratës rreth mungesave dhe nevojave të ARH, autoriteti ka deklaruar se ka nevojë për staf shtesë. Megjithatë, kapitulli 4.4.2 nuk paraqet një analizë të nevojave për staf shtesë, duke përfshirë analizën e pozitave të pambushura, ndërlidhshmërinë me planet e punës dhe detyrat e ARH-së dhe planifikimin për përmbushje. Për të siguruar raportim të plotë dhe shqyrtim të nevojave për përmbushje të mungesës së stafit, ARH duhet të paraqesë në të ardhmen analiza të tërthorta rreth nevojave të tyre.

Në seksionin e stafit, ARH gjithashtu thekson se pagat e punonjësve të autoritetit nuk janë kompetitive dhe ndikojnë në aftësinë e autoritetit për të siguruar staf të kualifikuar. Këtu gjithashtu ARH nuk ka dhënë informata shtesë rreth arsyeshmërisë për kërkesë për paga më të larta. Kjo arsyeshmëri duhet të marrë formën e krahasimit të pagave të punonjësve profesional me ato të personave ngjashëm të kualifikuar në fushën e tyre profesionale. Krahasimi sipërfaqësor me pagat e punonjësve të autoriteteve simotra në BE nuk aplikohet për shkak të ndryshimit drastik të kostove të jetesës në Kosovë përkundër kostos së jetesës në BE.

## **Raportimi rreth përgjegjësiave ligjore**

ARH në përgjithësi ka parashtruar një raport të detajuar të punës së tyre sa i përket detyrave ligjore jo-administrative të cilat ushtron autoriteti.

Raporti përfshin në një nivel relativisht të kënaqshëm përshkrimin e vizitave të ndryshme dhe punës së përbashkët që institucioni ka bërë gjatë vitit për përmbushjen e detyrës së tij. Megjithatë, në kapitullin 5.1 – rreth aktiviteteve të fushës së ARH-së, mungon një analizë e statistikave të plasura të cilat ndërlidhen me punën e ARH-së.

ARH paraqet në nivel të kënaqshëm të detajit statistikave rreth numrit të licencave për makinistë dhe numrit të autorizimeve për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore. Por në seksionin e aksidenteve hekurudhore dhe statistikave të personave të lënduara në aksidente hekurudhore mungojnë të dhëna.

Kjo bëhet më shqetësuese kur kemi parasysh se statistikave të plasura në raport nuk tregojnë trend të zvogëlimit të aksidenteve hekurudhore, sidomos për një vend ku operacionet hekurudhore janë mjaft të kufizuara. Në vitin 2017, për shembull, ARH tregon se ka pasur 16 persona të lënduar dhe 3 persona të vdekur në aksidente hekurudhore në vend. Kjo pason një trend të lehtë rritje nga viti 2015 (11 të lënduar dhe 2 të vdekur), 2016 (17 persona të lënduar, 1 i vdekur). Në kapitujt të cilët detajojnë punën rreth sigurisë hekurudhore, ARH gjithashtu nuk jep sqarime rreth këtyre aksidenteve dhe hapave që janë ndërmarra për parandalimin e tyre. Si rezultat, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të kushtohet vëmendje e veçantë shpjegimit të arsyeve për këto aksidente dhe hapave që ARH duhet të ndërmarrë për të siguruar uljen e tyre të menjëhershme.

Nga ana tjetër, ARH si rregullator i tregut të hekurudhave në Kosovë nuk ka dhënë sqarime rreth statistikave për bartje të personave dhe mallrave të cilat duket se janë mjaft të luhatshme. ARH duhet të përfshijë në raport një analizë të tregut dhe trendëve të cilat ndikojnë në suksesin dhe zgjerimin e tregut në vend. Për shembull, ARH tregon se gjatë 2017, numri i udhëtarëve me tren në vend është zvogëluar për 110,000 udhëtarë. Gjithashtu, në krahasim me vitin 2015, sasia e mallrave që kanë qarkulluar në hekurudha të Kosovës ka zbritur për 224 mijë ton neto. Për më shumë, mungon një analizë e cila diskuton impaktin që performanca e FerroNikelit, si një nga shfrytëzuesit më substancial të hekurudhave të Kosovës, ka në performancën e sektorit të hekurudhave në Kosovë.

Këto trende kërkojnë shpjegim të detajuar, dhe analizë të hapave të cilat ARH synon të ndërmerret për stimulimin e tregut të transportit hekurudhor në vend, sidomos për shkak të rëndësisë që kjo metodë transporti ka për industrinë. Andaj, INDEP e konsideron si të mangët pjesën e raportit e cila ka të bëjë me analizën e tregut dhe trendët të cilat ndikojnë në suksesin e tregut të hekurudhave në vend dhe synimeve afat-gjata të zhvillimit.

Për më shumë, kapitulli 5.4 i cili duhet të shpallë sfidat e vitit raportues dhe planifikimin për vitin vijues është tejet i mangët. ARH nuk jep shpjegime të detajuara rreth sfidave të cilat përmenden në këtë seksion dhe gjithashtu u mungon plasimi i planit të punës të vitit të ardhshëm. Për shkak të mungesës së këtyre pjesëve, monitorimi i suksesshëm i punës së ARH-së bëhet thuajse i pamundur. Prandaj, ARH duhet të sigurohet që në raportin e tyre vijues të përfshijë në detaj të dhëna rreth planit të tyre të punës për vitet vijuese dhe sfidave specifike në planet paraprake dhe parashikimin e sfidave të ardhshme.

## **Raporti Financiar**

Në përgjithësi, INDEP beson se ARH ka bërë një shpallje mjaft të detajuar të operacioneve financiare të autoritetit gjatë vitit. Vlen të theksohet se në raportimin financiar ka pasur krahasueshmëri vetëm në vitin paraprak, ndërkohë që praktikrat e mira kërkojnë krahasueshmëri me tre vitet paraprake.

Gjithashtu, ARH nuk ka shpjeguar ndërlidhjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe të trajnimit me listën e trajnimeve dhe vizitave të tyre jashtë vendit. Duke pasur parasysh se këto shpenzime përbëjnë një pjesë domethënëse të buxhetit të ARH, autoriteti duhet të shpallë në detaj shpenzimet e ndërlidhura me trajnime dhe udhëtime zyrtare për të siguruar mbikëqyrje adekuate nga Kuvendi i Kosovës.

Nga ana tjetër, ARH gjithashtu duhet të zgjerojë dukshëm kapitullin në të cilin autoriteti shpjegon gjendjen e përfshirjes dhe përmbushjes së rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Për vitin 2016, ZKA thekson:

“Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e pagave ishin të parregullta, disa nga shpalljet rreth buxhetit final nuk ishin prezantuar, avancet e pambyllura nuk ishin shpallur, vlera e stoqeve nuk ishte e saktë dhe informatat për detyrimet nuk ishin të plota.”

Raporti i Rregullsisë së ZKA ka theksuar gjashtë rekomandime për raportet e vitit 2016, hapat për përmirësimin e të cilave nuk janë shtjelluar në raportin vjetor për 2017 nga ARH. Si rezultat, raporti është i mangët sa i përket këtyre informatave dhe nuk mund të vlerësohet sfera e plotë e punës së ARH-së.

## **Përfundim**

INDEP beson se në përgjithësi, raporti i ARH-së tregon një përmbajtje përgjithësisht të mirë sa i përket raportit të punës për 2017. Megjithatë, ARH duhet të fokusohet në plasimin e informatave dhe analizave kyçe rreth punës së tyre sa i përket këtyre fushave:

1. ARH duhet të përfshijë një analizë të nevojave të saj për kërkesa për staf shtesë dhe nevojave për kompensim të stafit.
2. ARH duhet të përfshijë në raport shpjegime të detajuara rreth të dhënave statistikore, sidomos sa i përket sigurisë dhe performancës së tregut dhe parashikimeve të tyre rreth performancë së tregut.
3. Të përfshijë të dhëna të detajuara rreth objektivave të ARH-së dhe planit të punës të vitit të ardhshëm si dhe analizës së sfidave të kaluara dhe atyre të cilat parashikojnë të kenë institucioni.
4. Shpalosje të ndërlidhshmërisë së shpenzimeve të udhëtimit dhe trajnimit dhe vizitave / trajnimeve të anëtarëve të autoritetit.
5. Analizë të procesit të përmbushjes së rekomandimeve të ZKA të vitit paraprak dhe ndërlidhjes së këtyre rekomandimeve me efikasitetin e raportimit dhe mbikëqyrjes financiare.

Përmbajtja e Raportit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave					
Checklist					
		Po	Jo	N/A	Koment
<i>Forma e Përgjithshme e Raportit</i>					
<b>1</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>				
	a. Pikave kryesore të cilat elaborohen në raport	Po			
	b. Arritjet e agjencisë për vitin e raportimit	Po			
	c. Objektivat për vitin e ardhshëm	Po			Megjithatë, jo objektiva konkrete të përmbledhura shkurt.
<b>2</b>	<b>Baza Ligjore, Përmirësimet dhe Vështiresite</b>				
	a. Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të institucionit	Po			
<b>3</b>	<b>Përshkrimi i Institucionit</b>				
	a. Misioni / Vizioni dhe Kompetencat	Po			
	b. Departamente përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave	Po			
<b>4</b>	<b>Organizmi institucional</b>				
	a. Raportimi për organizimin e brendshëm të institucionit (bordi, ekzekutivi, deri te personeli)	Po			Nuk ka të dhëna për atë se kush e përbën bordin mbikëqyrës
	b. Puna e bordit gjatë vitit raportues	Po			
	c. Organogrami; Hapesira fizike dhe lokacionit; Deklarimi I mungesës së infrastruktures së nevojshme fizike	Po			Thuhet sa ka nevojë për staf (personel) shtesë
	d. Asetet	Po			
<b>5</b>	<b>Përshkrim i Tregut/Fushën që e mbulon institucioni</b>				
	a. Krahasimi i tregut për më se pak tri vitet paraprake dhe planeve për vitin vijues	Po			
	b. Çka ka ndërmarrë Institucioni që të përmirësohet/monitorohet tregu/fusha e veprimit	Po			
	c. Sfidat e vitit paraprak dhe planifikimi për vitin vijues	Po			
<b>6</b>	<b>Puna gjatë vitit paraprak</b>				

	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	Po			Megjithese nje pjese te mire te raportit e zene vizitat.
	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit	Po			
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato qe nuk jane arritur)			N/A	
<b>7</b>	<b>Raporti financiar</b>				
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	Po			
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet	Po			
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institucionit	Po			
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	Po			
	e. Investimet kapitale	Po			
	f. Tabelë krahasuese me buxhetin e tri viteve paraprake				Vetem me vitin paraprak
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	Po			
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri i udhëtimeve dhe personave qe kanë marrë pjesë		Jo		
<b>8</b>	<b>Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm</b>				
	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit			N/A	Nje paragraf i vetem i kushtohet raportit te ZAP
<b>9</b>	<b>Anekset</b>				
	a. Të dhënat për vendimet dhe lëshimin e licencave	Po			
	b. Të dhëna shtesë për informatat e përgjithshme të shtjelluara në raport	Jo			
<b>Specifikat e Raportimit</b>					
<b>#</b>	6.1.1. Urdhëresat për siguri si dhe interoperabilitet të sistemit hekurudhor të lëshuara dhe zbatueshmëria e tyre.		Jo		
<b>11</b>	6.1.2. Futja në punë e mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht	Po			
<b>#</b>	6.1.3. Licencat e lëshuara, amandamentuara, suspenduara dhe revokuara.				Vetem të lëshuarat dhe modifikuarat
<b>#</b>	6.1.4. Ankesat e pranuarat e të shqyrtuara, të ndara me kategori të llojit të tyre			N/A	



---

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)."